



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3670/19 prot

Datë 06.02.2025

V E N D I M
Nr. 194/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.02.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 45/2025, datë 13.01.2025 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-27307-10-30-2024, me objekt “Blerje asfaltobeton për shtrim rrugësh me afat 3 vjeçar për vitet 2024, 2025, 2026”, me fond limit 75,268,316 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

Ankimues: Operatori ekonomik “K.M.K” SHPK me NIPT L78223801E, me adresa: Bulevardi “Rrapo Hekali”, Shkalla 1, Kati 1, Z. Kadastrale 1090, Nr.Pasurie 7/9810, Ballsh, Mallakastër.

BOE “General Beton” SHPK & “Shkëlqimi 07” SHPK përkatësisht me NUIS K23013401A e NUIS K68121808Ë me adresë: Rruga Fier- Patos km.5, kthesa e Patosit, zona kadastrale me nr.2890, nr.pasurie 59/14, kantier ndert, Patos.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Patos
Adresa: Lagja “Naftëtari”, Rruga “Unaza, Patos

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I****Rrethanat e çështjes**

I.1. Në datë 13.01.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 45/2025, ku vendosi:

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga BOE “General Beton” SHPK & “Shkëlqimi 07” SHPK për skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-27307-10-30-2024, me objekt “Blerje asfaltobeton për shtrim rrugësh me afat 3 vjeçar për vitet 2024, 2025, 2026”, me fond limit 75,268,316 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “K.M.K” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e prokurimit në SPE në përputhje me konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik në këtë vendim.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga “General Beton” SHPK & “Shkëlqimi 07” SHPK.
6. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “K.M.K” SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 3863/28 prot., datë 30.01.2025, me objekt: “Informacion mbi zbatimin e vendimit nr.45/2025”, protokolluar me tonën nr. 3670/15 prot., datë 03.02.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Patos, njofton se: “[...] në datën 23.01.2025, nëpërmjet shkresës nr. 3863/21 prot., datë 21.01.2025, i ka dërguar OE “K.M.K” SHPK kërkesë për sqarim, në zbatim të vendimit të KPP-së dhe në datën 27.01.2025 u dorëzua në SPE kthim përgjigje e operatorit ekonomik “K.M.K” SHPK, e cila u shqyrtua nga KVO, i cili vazhdoi me vlerësimin dhe hapat vijues të procedurës të cilat janë pasqyruar në procesverbalin e rivlerësimit nr. 3863/27 prot., datë 29.01.2025.” Bashkëngjitur kësaj shkrese është dokumentacioni si vijon: Urdher për zbatim vendimi nr. 3863/20 prot., datë 20.01.2025; Njoftim për hapje të rivlerësimit nr. 3863/21 prot., datë 21.01.2025; Kërkesë për sqarim operatorit ekonomik “K.M.K” SHPK

me nr. 3863/22 prot; Kthim përgjigje kërkesës për sqarim operatorit ekonomik “K.M.K” SHPK date 27.01.2025, bashkëlidhur print screen i (SPE); Procesverbal mbi shqyrtimin e kthim përgjigjes operatorit ekonomik “K.M.K” SHPK; Procesverbal i rivleresimit nr. 3863/27 prot., datë 29/01/2025 dhe renditja perfundimtare.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 3863/28 prot., datë 30.01.2025, me objekt: *“Informacion mbi zbatimin e vendimit nr.45/2025”*, protokolluar me tonën nr. 3670/15 prot., datë 03.02.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Patos, njofton se: *“[...] në datën 23.01.2025, nëpërmjet shkresës nr. 3863/21 prot., datë 21.01.2025, i ka dërguar OE “K.M.K” SHPK kërkesë për sqarim, në zbatim të vendimit të KPP-së dhe në datën 27.01.2025 u dorëzua në SPE kthim përgjigje e operatorit ekonomik “K.M.K” SHPK, e cila u shqyrtua nga KVO, i cili vazhdoi me vlerësimin dhe hapat vijues të procedurës të cilat janë pasqyruar në procesverbalin e rivlerësimit nr. 3863/27 prot., datë 29.01.2025.”* Bashkëngjitur kësaj shkrese është dokumentacioni si vijon: Urdher per zbatim vendimi nr. 3863/20 prot., datd 20.01.2025; Njoftim per hapje te rivleresimit nr. 3863/21 prot., date 21.01.2025; Kërkesë për sqarim operatorit ekonomik “K.M.K” SHPK me nr. 3863/22 prot; Kthim përgjigje kërkesës për sqarim operatorit ekonomik “K.M.K” SHPK date 27.01.2025, bashkëlidhur print screen i (SPE); Procesverbal mbi shqyrtimin e kthim përgjigjes operatorit ekonomik “K.M.K” SHPK; Procesverbal i rivleresimit nr. 3863/27 prot., datë 29/01/2025 dhe renditja perfundimtare.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik, bëri verifikimet përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.45/2025, datë 13.01.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga ky verifikim, rezultoi se, autoriteti kontraktor ka rivlerësuar procedurën e prokurimit në SPE, në përputhje me konstatimet e KPP-së në vendimin Nr.45/2025, datë 13.01.2025.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar; nenit 46 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*; Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-27307-10-30-2024, me objekt “*Blerje asfaltobeton për shtrim rrugësh me afat 3 vjeçar për vitet 2024, 2025, 2026*”, me fond limit 75,268,316 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

